



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion

Mbledhja nr. 24/2008

Më 12.11.2008, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-225

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani- kryetare e komisionit, Haki Shatri, Fatmir Rexhepi, Berim Ramosaj, Zef Morina, Mufëra Şinik.

Munguan: Kaqusha Jashari, Ethem Ceku, Sala Berisha-Shala, Slobodan Petroviq, Safete Hadergjonaj.

Të pranishëm: Faruk Hajrizi, Krenare Sfishta, Izet Arifi, përfaqësuesit e MTI-së, Fahredin Maqestena, Petrit Pepaj-KEK-ut, Sagita Muço dhe Besim Zeqiri-ICO; Blerina Uka NDI, Valon Hyseni nga KDI- dhe Haxhi Gashi nga USAID-i;

Nga Zyra Mbështetëse: Hasan Tahiri, Advie Morina, dhe Nurie Morina;

Mbledhjen e drejtoi: Myzejene Selmani- kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 04.11.2008;
3. Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë së Republikës nr. 03/38 të dt. 2 tetor 2008, lidhur me fillimin e procedurave të privatizimit të distribuimit dhe furnizimit të KEK-ut;
4. Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë për zgjedhjen e anëtarëve të Bordit për Zyrën e Rregullatorit të Energjisë;
5. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit Nr.02/L-20 për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit;
6. Shqyrtimi i Projektligjit për masat e antidampingut;
7. Të ndryshme;

I. Miratimi i rendi të ditës;

Rendi i ditës u miratua me ndryshim që pika e dytë të shtyhet për mbledhjen e radhës;

II. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 04.11. 2008;

Procesverbali i mbledhjes së dt.04.11.2008, u miratua pa vërejtje.

III.Shqyrtimi i Vendimit te Qeverisë për zgjedhjen e anëtarëve të Bordit për Zyrën e Rregullatorit të Energjisë;

Kryetarja - e njoftoi Komisionin me materialin shtesë të cilin e ka kërkuar nga qeveria, për Bordin e ZRRE-së, për plotesimin e dokumentacionit të këtyre dy kandidatëve, Përparim Kabashin, inxhinjer i elektronikës dhe Blerim Kocin, inxhinier i makinerisë, materiali shtesë ju është shpernda, në fund kërkoi nga anëtarët e Komisionit që ta bëjnë përzgjedhjen dhe hapi diskutimin.

Haki Shatri - tha se lidhur më këtë çështje jemi vonuar ngase dokumentacionin e kemi pasur me kohë, mirëpo propozoi që te behët përzgjedhja e këtyre anëtarëve të bordit për mos ngecjen e punës, por shfaqti shqetesimin e ZRRE-së, të cilet kanë kërkuar që njëri kandidatë të jetë me profesion juristë, sepse duhet të jetë njëri anëtar i Bordit jurist, përndryshe ai tha se kriteret janë të plotesuara më biografitë e nevojshme.

Zef Morina – theksoj së pajtohet me parafolësin, nga se është kohë e gjatë që janë dorëzuar materialet, andaj shfaqti mendimin se duhet të bëhet përzgjedhja e kandidatëve në menyrë që Bordi të funksionon, që ka nevojë diçka tjetër ata kanë mundësi ta bejnë ndryshimin, mirëpo nga ne nuk është mirë ta prelongojmë zgjedhjen e këtyre kandidatve tha në fund z.Morina.

Fatmir Rexhepi – tha se apstenon në votimin e tij duke shtuar se nuk e kemi shumicën e kandidatëve dhe votimi nuk vlen.

Pas diskutimit të gjerë, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

- I. Për shkak të votës së përmbajtur të shumicës së anëtarve të Komisionit, Vendimi i Qeverisë për zgjedhjen e anëtarëve të Bordit për Zyrën e Rregullatorit të Energjisë, të shqyrtohet mbledhje e radhës;

IV.Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit Nr.02/L-20 për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit;

Kryetarja – propozoi që në vazhdim të shqyrtohet Raporti i Grupit Punues, për Ndryshimin dhe Plotësimin të Ligjit Nr.02/L20 për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit.

Zef Morina – në emër të Grupit Punues, njoftoi komisionin lidhur me punën rreth P/ligjit për Ndryshim dhe Plotësimin e Ligjit Nr.02/L20 për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit, ku te gjitha propozimet janë pranuar nga Grupi Punues përveç

një amendamenti: Te neni 7. i P/ligjit ndryshohet si vijon: në nenin 16 paragrafi 1. i Ligjit ekzistues shuma e propozuar prej 5-15 mijë euro është ndryshuar, dhe është bërë 3-5 mijë euro. Më arsyetimin se shuma e propozuar është e lartë dhe ne kërkojmë nga Komisioni që ta pranoj këtë ndryshim.

Pas diskutimit të gjerë Komisioni unanimisht nxori këtë:

Përfundim

- I. Miratohet raporti i grupit punues, i Projektligjit për Ndryshim dhe Plotësimin e Ligjit Nr.02/L20 për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit;
- II. Autorizohet administrata që të hartojë Raprtin më Rekomandime për seancë plenare;

V. Shqyrtimi i Projektligjit për Masat e Antidamping;

Kryetarja – ia dha fjalën kryesuesit të Grupit Punues z.Berim Ramosaj, për të raportuar për procesin e shqyrtimit të këtij projektligji.

Berim Ramosaj – theksoj se meqenëse Komisioni është në përgatitje edhe të ligjeve të tjera të kësaj natyre, propozoj që të shtyhet kjo pikë të rendit të ditës. Pasiqë të harmonizohen qëndrimet edhe me z.Haxhi Gashi (USAID), që në fakt edhe këta janë të inkorporuar në këtë proces dhe pastaj do të dalim me propozime konkrete, tha z.Ramosaj.

VI. Të ndryshme;

Kryetarja – propozoj që të mbahet Takimi më datë 18.11.2008, për Ligjin për Shpronësimin poashtu të mbahet mbledhja e radhës më datë 17.11.2008 dhe të ftohet ministri Shala në Komision.

Pas diskutimeve të gjëra, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

- I. Komisioni organizon mbledhjen e radhës më 17.11.2008, në ora 11.00 dhe në rend dite të jetë: Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë së Republikës nr. 03/38 dt. 2 tetor 2008, lidhur me fillimin e procedurave të privatizimit të distribuimit dhe furnizimit të KEK-ut;
- II. Komisioni organizon Takimin për amendamentimin e Ligjit Nr.02/L-97 për shpronësim, më datë 18.11.2008; në ora 10.00 në Vermicë-Prizren;

Mbledhja përfundoi në orën 12.00

Kryetare e Komisionit
Myzejene Selmani